



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVETKOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KOMISIONI DISIPLINOR//DISCIPLINSKA KOMISIJA/ THE DISCIPLINARY COMMITTEE

KD.nr.8/2017

KOMISIONI DISIPLINOR, në përbërje nga gjyqtarët: Nenad Lazic, kryetar, Armend Berisha dhe Gjimeshit Galushi, anëtarë të Komisionit, duke e shqyrtuar çështjen e përgjegjësisë disiplinore ndaj Xxxx xxxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Xxxxxx, sipas raportit përfundimtar të ZPD - 2016-147, i njëjti në procedurë të Komisioni Disiplinor ka marrë numrin KGJK/KD/03/2017, për pretendimin për sjellje të pahijshme të përcaktuar sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Shkelje e Kodit të etikës për gjyqtar, në seancën dëgjimore të mbajtur në prezencën e përfaqësuesit të ZPD-së, z. Arianit Salihu dhe gjyqtarit Xxxx xxxxx me datë 12.05.2017 merr këtë:

V E N D I M

Xxxx xxxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Xxxxxx, **nuk** është përgjegjëse për sjellje të pahijshme, të përcaktuar sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223), dhe Shkelje e Kodit të etikës për gjyqtar siç është pretenduar në raportin përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor, ZPD-2016-147.

A r s y e t i m

Komisioni Disiplinor e ka pranuar nga Zyra e Prokurorit Disiplinor Raportin Përfundimtar ZPD-2016-147, se bashku me shkesat e lëndës më të cilin e ka ngarkuar Xxxx xxxxxn, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për sjellje të pahijshme të përcaktuara në sipas nenit 34 pika 1.2-neglizhenc në kryerjen, dështimin për të kryer apo abuzim me funksionet gjyqësore, 1.3- të dështuarit e kryerjes së funksioneve gjyqësore në mënyrë të pavarur dhe të paanshëm dhe shkelje të Kodit të Etikës për Gjyqtar.

Zyra e Prokurorit Disiplinor e kishte filluar hetimin disiplinor në bazë të parashtresës së pranuar prej xxxxx xxxx më të cilën kishte shfaqur shqetësimin e tij lidhur me zvarritjen në vendosjen e lëndës penale P.nr.333/12, nga Xxxx xxxxx, Gjyqtar në gjykatën Themelore në xxxxxxxx, për shkak se ishte paraqitur parashkrimi absolut i lëndës. Hetimin e kishte zhvilluar me pretendimin se gjyqtari xxxxx e kishte ushtruar funksionin gjyqësor me neglizhencë dhe si rezultat i kësaj kishte ardhur deri të parashkrimi i ndjekjes penale në lëndën P.nr.333/12. Kjo lëndë në fillim kishte qenë të gjyqtarja Xxxxx xxxxx, pastaj me datë 16 nëntor 2012 ka bërë

kërkesë për përjashtim sepse njërin nga palët e ka pasur kushëri. Pas dy dite me datë 29 nëntor kjo lëndë ju kishte ndarë gjyqtarit Xxxx xxxxx, i cili veprimin e parë e kishte ndërmarr me datë 16 shkurt 2014, pra pas nja viti e kishte ndërmarr veprimin e parë. Sipas pretendimit të ZPD-së në këtë kohë veçse kishte arritur parashkrimi relativ. Gjyqtari xxxx kishte vazhduar edhe me tutje rreth vendosjes së kësaj lëndë dhe se seancën tjetër e kishte caktuar me datë 17 tetor 2014. Pra është një kohë relativisht e gjatë mbi bazën e të cilave një shqyrtim gjyqësor kishte filluar. Kishte vazhduar prapë deri kur ka konstatuar parashkrimin absolut dhe një gjë të tillë e konstaton edhe Gjykata e Apelit kur e ka hudhur ankesën e paditësit në këtë çështje penale.

Në seancën dëgjimore të Komisionit Disiplinor të mbajtur me datë 12.05.2017, Zyra e Prokurorit Disiplinor e ka mbështetur në tërësi raportin përfundimtar ZPD-2016-147.

Gjyqtari xxxxxx në seancën e Komisionit Disiplinor ka deklaruar se nuk ka arritur të kuptoj se në këtë raport të ZPD-së për çfarë neglizhence jam akuzuar. Është e vërtet se këtë lëndë e kam trashëguar nga gjyqtarja xxxxx Xxxxx, dhe po ju tregoj se kjo lëndë ka qenë me padi private, pra padia është ushtruar para hyrjes në fuqi të Kodit të ri të Procedurë Penale të Republikës së Kosovës. Më këtë lëndë gjyqtari ishte ngarkuar me datë 29 nëntor 2012, dhe se kur e kam pranuar këtë lënë sipas strategjisë kombëtare kemi qenë të obliguar që të merremi me lëndët e vjetra, sepse lëndë konkrete është konsideruar si lëndë e re, sepse ka pasur lëndë shumë ma të vjetra. Kemi qenë të obliguar me e respektuar strategjinë në përpikëri. Pavarësisht kësaj gjyqtari ka deklaruar se është shumë i kënaqur sepse kishte ndërmarr shumë veprime lidhur më këtë lëndë. I kishte caktuar gjithsej 10 seanca lidhur me këtë lëndë. Theksoj se ka qenë shumë i ngarkuar më lëndë, kishte pasur gjithsej 1545 dhe nuk beson se në ndonjë lëndë tjetër ka ndërmarr më shumë veprime. Në tri seanca të datave 11.02.2015, 21.04.2015, dhe 06.02.2015 vetë pala paditëse Ahmet xxxx kishte munguar. Një seancë e datë 06.03.2015 nuk është mbajtur për shkak të grevës së punëtorëve të Gjykatës. Nuk qëndron pretendimi i prokurores që unë kam ndërmarr veprim edhe pas parashkrimit absolut të kësaj lëndë. Unë jam i vetëdijshme që lëndë pasi të parashkruhet asnjë veprim ndaj të akuzuarit më nuk ka efekt, por sidoqoftë gjyqtari e kishte përcjelluar me një akt përcjellës tek Gjykata e xxxxx, dhe po mendoj që inspektorja po mendon që ky është veprim konkret që e kam kryer pasi lënda është parashkruar.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i ZPD-së deklaroj se gjyqtari xxxxx ka pasur mundësi që me një angazhim me të madh, përkundër ngarkesës shumë të madhe me lëndë, ta ndërpre bile parashkrimin relativ të lëndës penale P.nr.333/12 .Vepra penale kontestuese e Kanosjes është vepër për të cilën parashihet një dënim shumë i vogël dhe se mundësia me ardh deri të parashkrimi është shumë i shpejtë për shkak të afateve kohore, andaj gjyqtari pavarësisht strategjisë është dashur që ta ndërmerre ndonjë veprim që ta ndërpriste bile parashkrimin relativ. Në këtë rast konkret gjyqtari është treguar neglizhent, veprimin e parë e ka ndërmarr pas një viti, të dytin pas 7-8 muajve. Nuk mundet mundemi me mohuar që gjyqtari ka qenë i ngarkuar me një numër të madhtë lëndëve gjithsej 1545 lëndë dhe se kjo ka qenë një ngarkesë shumë e madhe, dhe i kishte përfunduar 760 lëndë, sukses që nuk mundet ta mohoj as ZPD e as KGJK-ja.

Gjyqtari xxxxx në fjalën përfundimtare deklaroj se i vjen shumë keq prej prokurorit disiplinor qe nuk e ka të qartë rrjedhën e parashkrimeve, dhe se parashkrimi relativ nuk rrjedh prej datës kur është kryer vepra penale por prej veprimit të fundit qe është ndërmarr në atë lëndë. Absolutisht nuk konsideron se në këtë lëndë ka bërë ndonjë neglizhencë apo shpërdorim.

Komisioni Disiplinor i administroj të gjitha provave në shkresat e lëndës, shqyrtoj parashkresat e dorëzuar nga ZPD-ja që kanë qenë të bashkangjitura në raportin përfundimtar, provat e dorëzuar nga gjyqtari, ka dëgjuar edhe deklaratën e gjyqtarit xxxxx të dhënë gjatë seancës.

Në bazë të provave të analizuara me kujdes, dhe deklarimit të gjyqtarit në seancë, Komisioni konstaton se gjyqtari xxxxx nuk ka bërë sjellje të pahijshme dhe nuk ka shkelur standardet e kodit të etikës me rastin e parashkrimit relativ dhe absolut të lëndës penale P.nr.333/12.Gjyqtari xxxxx lëndën e kishte pranuar me datë 29 nëntor 2012, i kishte caktuar gjithsej 10 seanca gjyqësore. Në tri seanca vetë paditësi kishte munguar, një seancë nuk ishte mbajtur për shkak të grevës së punëtoreve, një seancë ishte shtyrë për shkak të propozimit për dëgjim të dëshmitareve.

Komisioni po ashtu konstaton qe gjyqtari nuk ka neglizhuar me lëndën kontestues penale të kanosjes P.nr.333/12 ashtu siç pretendon ZPD-ja, ka zbatuar me përpikëri strategjinë kombëtare për zhvillimin e lëndëve të vjetra, ka qenë i stërngarkuar me lëndë, dhe me gjithë këtë, ka arritur të zgjidh një numër shumë të madh të lëndëve.

Duke patuar parasysh të gjitha këto, Komisioni vlerëson se në këtë rast, gjyqtari xxxxx nuk ka kryer sjellje të pahijshme siç pretendon ZPD dhe nuk është involvuar me ndonjë veprim konkret qe do të rezultonte me shkelje të standardeve të sjelljeve profesionale për gjyqtarë.

Prandaj, nga këtu dhe nga arsyet e sipër theksuara, Komisioni ka konstatuar se gjyqtari Xxxx xxxxx **nuk** është përgjegjëse për sjellje të pahijshme të parapara me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1, pika 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223), dhe Shkelje e Kodit të etikës. Në seancën për këshillim dhe votim, njëzëri vendosi qe Xxxx xxxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë të lirohet nga përgjegjësia disiplinore, prandaj vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR
KD.nr.08/2017, datë 12.05.2017

Kryetar i Komisionit Disiplinor
Gjyqtari, Nenad Lazic

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në Prishtinë, brenda 15- ditësh nga dita e pranimin të Vendimit.

Vendimi t'u dërgohet:

- Nehat Idrizi, kryesues i KGJK-ës;
- Zef Prendrecaj, drejtor, Zyra e Prokurorit Disiplinor;
- Xxxxx xxxx, kryetare e Gjykatës Themelore në xxxxx;
- Xxxx xxxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në xxxxx;
- Departamentit të Administratës dhe Personelit në SKGJK;